

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:(210-26-5765-5-5-8)

Sa i përket tenderit për(Blerja e pajisjeve të TI-së për nevojat e MMPH-së)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ARITECH SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan, përball QMI

(Adresa)

Graçanicë

10500

(Vendi)(Kodi postar)

+383 38 600 500

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Fahri Avdiu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

fahri@aritechks.com

(Adresa elektronike)

27.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ftesa për oferte është dërguar në e-prokurim me dt. 15.07.2026

Afati i fundit për dorëzim të ofertes është me date 27.07.2026 h 13:30..

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kjo ankesë paraqitet pas përfundimit të procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjes pranë Autoritetit Kontraktues. ARITECH SH.P.K., më 21.07.2026, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër dokumenteve të tenderit, përkatësisht kundër specifikimeve teknike të cilat, sipas vlerësimit tonë, kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë një prodhues të caktuar. Me vendimin e datës 24.07.2026, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim. Megjithatë, ndryshimet e bëra janë kryesisht formale dhe nuk e eliminojnë në mënyrë funksionale karakterin kufizues të specifikimeve teknike. Për më tepër, ndonëse në vendim është theksuar se afati për dorëzimin e ofertave do të zgjatet, në praktikë afati ka mbetur i pandryshuar. Për këto arsye, dhe me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesit tonë ligjor, jemi të detyruar ta paraqesim këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Neni 28
Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.
7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

ARITECH SH.P.K. është operator ekonomik i interesuar për pjesëmarrje në aktivitetin e sipërhënuar të prokurimit dhe ka interes të drejtpërdrejtë juridik dhe ekonomik që procedura të zhvillohet në përputhje me parimet e konkurrencës, trajtimit të barabartë, transparencës dhe mosdiskriminimit.

Specifikimet teknike të publikuara, mënyra e trajtimit të kërkesës për rishqyrtim dhe moszgjatja efektive e afatit kanë cenuar mundësinë reale të ankuesit për të përgatitur dhe dorëzuar një ofertë të përgjegjshme dhe konkurruese.

Për këtë arsye, ankuesi është palë e interesuar dhe e dëmtuar nga veprimet dhe mosveprimet e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull “Blerja e pajisjeve të TI-së për nevojat e MMPH-së”, me numër prokurimi **210-26-5765-5-5-8**.

Pas analizimit të Dosjes së Tenderit dhe specifikimeve teknike, ARITECH SH.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, duke kundërshtuar një numër të madh kërkesash teknike të cilat, të marra së bashku, krijojnë një profil tepër të ngushtë të pajisjeve dhe përputhen në masë të lartë me modele konkrete të një prodhuesi të caktuar.

Në kërkesën për rishqyrtim janë identifikuar, ndër të tjera, përputhje të larta me modelet:

- Lenovo ThinkCentre neo 50t Gen 5;
- Lenovo ThinkVision E27-40;
- Lenovo V15 G5 IRL;

- Lenovo ThinkCentre M70t Gen 6.

Kërkesa për rishqyrtim është mbështetur me katalogë dhe dokumentacion teknik të modeleve përkatëse.

Me vendimin e datës **24.07.2026**, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim dhe ka deklaruar se Dosja e Tenderit do të korrigjohet dhe se do të bëhet zgjatja e afatit të hapjes së ofertave.

Megjithatë:

1. pjesa kryesore e specifikimeve kufizuese ka mbetur e pandryshuar;
2. pretendimi për efektin kumulativ të specifikimeve nuk është shqyrtuar në mënyrë substanciale;
3. vendimi për zgjatjen e afatit nuk është zbatuar efektivisht;
4. operatorëve ekonomikë nuk u është dhënë kohë reale shtesë për përgatitjen e ofertave pas korrigjimit të Dosjes së Tenderit.

Aritech Shpk konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me:

- nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, lidhur me përdorimin efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike;
- nenin 6 të LPP-së, lidhur me ekonomicitetin dhe efikasitetin;
- nenin 7 të LPP-së, lidhur me barazinë në trajtim, mosdiskriminimin dhe transparencën;
- nenin 28 të LPP-së, lidhur me formulimin jodiskriminues të specifikimeve teknike;
- nenin 108/A të LPP-së, lidhur me shqyrtimin efektiv të kërkesës për rishqyrtim;
- nenin 19 të Rregullores për Prokurimin Publik, lidhur me qartësinë, saktësinë, proporcionalitetin dhe formulimin funksional të specifikimeve teknike;
- parimin e sigurisë juridike dhe detyrimin e organit administrativ për ta zbatuar vendimin e vet.

PRETENDIMET ANKIMORE

1. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar pretendimin kryesor për efektin kumulativ të specifikimeve

Pretendimi i ARITECH SH.P.K. nuk ka qenë se vetëm një kërkesë teknike, e analizuar veçmas, është diskriminuese.

Pretendimi kryesor ka qenë se **kombinimi kumulativ** i të gjitha kërkesave:

- numri dhe lloji i porteve USB;
- shpejtësitë e porteve;
- USB-C me funksion karikimi;
- kombinimet HDMI dhe DisplayPort;
- HDMI 2.1;
- lexuesi 3-në-1 i kartelave;
- numri dhe konfigurimi i sloteve të memories;
- fuqia e furnizimit me energji;
- teknologjitë e BIOS-it;
- bllokimi selektiv i USB storage;
- parametrat specifikë të monitorit;
- porta VGA;
- altoparlantët 2 W × 2;
- kërkesat për aksesore të së njëjtës markë;

krijon një profil teknik që përputhet pothuajse plotësisht me modele konkrete dhe e kufizon ndjeshëm numrin e produkteve të pranueshme.

Në vendimin e kundërshtuar, AK nuk ka bërë analizë krahasuese të specifikimeve me katalogët e bashkëngjitur dhe nuk ka sqaruar se cilat modele të prodhuesve të tjerë i plotësojnë të gjitha kërkesat në mënyrë kumulative.

AK është mjaftuar me deklarimin e përgjithshëm se:

Autoriteti Kontraktues pranon modele nga të gjithë prodhuesit, me kusht që pajisjet e ofruara të plotësojnë ose tejkalojnë minimumin e specifikimeve teknike.

Një deklaram i tillë nuk i përgjigjet pretendimit të ankuesit.

Çështja nuk është nëse teorikisht pranohen të gjithë prodhuesit, por nëse specifikimet e hartuara u mundësojnë realisht prodhuesve të ndryshëm të konkurrojnë.

Nëse vetëm një ose një numër shumë i kufizuar modelesh i plotëson të gjitha kërkesat e kombinuara, atëherë konkurrenca mbetet e kufizuar, pavarësisht deklarimit formal se pranohen të gjithë prodhuesit.

Vendimi nuk përmban arsyetim të plotë dhe individual për pretendimet e ngritura

AK nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar për secilën çështje të ngritur në kërkesën për rishqyrtim.

Për kërkesat lidhur me riformulimin e specifikimeve në bazë të performancës dhe lejitimin e produkteve të barasvlershme, AK vetëm i është referuar përgjigjes së parë.

Nuk është shpjeguar:

- pse duhet pikërisht numri i përcaktuar i porteve;
- pse nuk mund të pranohen kombinime të ndryshme që ofrojnë të njëjtin funksionalitet;
- pse duhet lexuesi i emërtuar “3-in-1”;
- cilat lloje konkrete kartelash përdor AK;
- pse nuk mund të pranohet lexues SD/SDHC/SDXC ose një zgjidhje e jashtme e barasvlershme;
- pse kërkohet njëkohësisht HDMI, DisplayPort dhe VGA;
- pse dallimet jomateriale në konfigurimin fizik duhet të jenë kushte eliminuese;
- cilat alternativa reale nga prodhues të tjerë janë analizuar para hartimit të specifikimeve.

Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë lidhjen konkrete ndërmjet nevojës së Autoritetit Kontraktues dhe secilës kërkesë kufizuese.

Formulimet e përgjithshme si “nevojë funksionale”, “fleksibilitet” ose “përdorim afatgjatë” nuk përbëjnë vetvetiu arsyetim të mjaftueshëm, pa u mbështetur me të dhëna konkrete mbi pajisjet ekzistuese, proceset operative ose nevojat e dokumentuara të institucionit.

Ndryshimet e bëra në Dosjen e Tenderit janë kryesisht formale dhe nuk e eliminojnë kufizimin e konkurrencës

Pas kërkesës për rishqyrtim janë bërë disa korrigjime, ndër të cilat:

- është shtuar shprehja “ose ekuivalent” te Intel BIOS Guard;
- është shtuar “ose ekuivalent” te Self-healing BIOS;
- është shtuar “ose ekuivalent” te Natural Low Blue Light;
- është hequr kërkesa që monitori të jetë i së njëjtës markë me PC-në;
- janë korrigjuar disa gabime teknike dhe emërtime;
- është hequr kërkesa e formuluar gabimisht për kontrastin e laptopit;
- është sqaruar pjesërisht kërkesa për garancinë.

Megjithatë, kanë mbetur të pandryshuara kërkesat kryesore që krijojnë profilin e ngushtë teknik, përfshirë kombinimin specifik të porteve, lexuesin 3-në-1, fuqinë e caktuar të furnizimit me energji, konfigurimin e monitorit dhe kërkesat e tjera fizike. Shtimi i shprehjes “ose ekuivalent” pas një emërtimi teknik nuk e eliminon automatikisht kufizimin, nëse pjesa tjetër e konfigurimit vazhdon ta identifikojë praktikisht një model të caktuar.

Ekuivalenca duhet të jetë reale dhe e zbatueshme, jo vetëm deklarative.

Specifikimet vazhdojnë të orientohen drejt modeleve konkrete

Ankuesi ka identifikuar se specifikimet përputhen në masë të lartë me:

Kategoria	Modeli me të cilin përputhet specifikimi
------------------	---

PC – Model I	Lenovo ThinkCentre neo 50t Gen 5
--------------	----------------------------------

Monitor – Model III	Lenovo ThinkVision E27-40
---------------------	---------------------------

Laptop – Model II	Lenovo V15 G5 IRL
-------------------	-------------------

PC – Model II	Lenovo ThinkCentre M70t Gen 6
---------------	-------------------------------

AK nuk ka kundërshtuar konkretisht asnjë nga këto përputhje.

Nuk ka paraqitur modele alternative nga HP, Dell, Acer, ASUS, Fujitsu ose prodhues të tjerë që i plotësojnë të gjitha kërkesat e kombinuara.

Nuk mjafton që specifikimi të mos përmbajë shprehimisht emrin “Lenovo”. Favorizimi mund të bëhet edhe në mënyrë indirekte, përmes kopjimit ose bashkimit të karakteristikave dalluese të një modeli të caktuar.

Neni 28 i LPP-së duhet të zbatohet sipas efektit real të specifikimit, jo vetëm sipas formulimit formal të tij.

Kombinimi i porteve është mbajtur pa arsyetim të mjaftueshëm dhe pa lejimin e alternativave funksionalisht të barasvlershme

AK ka deklaruar se numri dhe kombinimi i porteve janë përcaktuar për lidhshmëri optimale, fleksibilitet dhe përdorim afatgjatë.

Megjithatë, nuk ka shpjeguar pse nevojiten pikërisht:

- katër ose gjashtë porte USB-A me një shpejtësi të caktuar;
- porte të tjera USB-A Hi-Speed;
- USB-C me charging;
- HDMI 2.1;
- një ose dy DisplayPort;
- lexues 3-në-1.

Pajisje të prodhuesve të ndryshëm mund të ofrojnë të njëjtin ose nivel më të lartë të lidhshmërisë përmes një konfigurimi tjetër, për shembull me:

- një port më pak USB-A dhe një port më shumë USB-C;
- DisplayPort me version më të ri;
- HDMI me version funksionalisht të mjaftueshëm;
- adaptorë ose docking station;
- lexues standard SD në vend të “3-in-1”.

Eliminimi i një pajisjeje vetëm për shkak të organizimit fizik të porteve, kur ajo ofron funksionalitet të barasvlershëm ose më të lartë, nuk është proporcional me qëllimin e prokurimit.

6. Kërkesa për lexuesin 3-në-1 nuk është arsyetuar me prova konkrete

AK ka deklaruar se lexuesi 3-në-1 është i nevojshëm për kompatibilitet me lloje të ndryshme të kartelave memoruese që përdoren në proceset e punës.

Megjithatë, AK nuk ka specifikuar:

- cilat janë tri formatet konkrete të kartelave që përdoren;
- sa shpesh përdoren;
- në cilat procese administrative përdoren;
- pse një lexues SD/SDHC/SDXC nuk është i mjaftueshëm;
- pse nuk mund të pranohet një lexues i jashtëm i certifikuar;
- pse ky element duhet të jetë i integruar në çdo pajisje.

Pa këto të dhëna, konstatimi se kërkesa nuk e kufizon konkurrencën është vetëm deklarativ.

Mbajtja e portës VGA nuk është arsyetuar në mënyrë të verifikueshme

AK ka deklaruar se porta VGA kërkohet për kompatibilitet më të gjerë me pajisje ekzistuese dhe sisteme të mundshme gjatë ciklit jetësor të monitorëve.

Megjithatë, nuk ka identifikuar:

- pajisjet konkrete ekzistuese që kanë vetëm dalje VGA;
- numrin e pajisjeve të tilla;
- periudhën e parashikuar të përdorimit të tyre;
- arsyen pse nuk mund të përdoret adaptor HDMI/DisplayPort–VGA;
- arsyen pse çdo monitor duhet ta ketë të integruar këtë port analog.

Vetë kompjuterët e rinj të kërkuar në të njëjtin aktivitet kanë dalje HDMI dhe DisplayPort. Prandaj kërkesa për VGA duhet të mbështetet me një nevojë konkrete dhe të dokumentuar, jo me mundësi hipotetike.

Kërkesa për garancinë është sqaruar vetëm pjesërisht

AK ka sqaruar se garancia duhet të jetë e verifikueshme në faqen zyrtare të prodhuesit përmes numrit serik të pajisjes.

Këto elemente duhet të sqarohen paraprakisht, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë ta interpretojnë dhe dëshmojnë kërkesën në mënyrë të njëjtë.

MOSZBATIMI I VENDIMIT TË AK-së PËR ZGJATJEN E AFATIT

AK ka vendosur zgjatjen e afatit, por nuk e ka zbatuar atë në praktikë

Ky pretendim përbën një shkelje të veçantë dhe të pavarur procedurale.

Në fund të vendimit të datës **24.07.2026**, Autoriteti Kontraktues ka deklaruar shprehimisht: “Dosja e tenderit do të korrigjohet sipas LPP-së dhe do të bëhet edhe zgjatja e afatit të hapjes së ofertave.”

Pas nxjerrjes së këtij vendimi, AK ka publikuar një njoftim për operatorët ekonomikë ku ka deklaruar:

“Për shkak të këtyre ndryshimeve, afati për dorëzimin e ofertave është shtyrë.”

Megjithatë, në të njëjtin njoftim është përcaktuar se:

“Hapja e ofertave do të bëhet më datë 27.07.2026, në ora 13:30.”

Data **27.07.2026, ora 13:30**, ishte data dhe ora e përcaktuar edhe para paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim dhe para korrigjimit të Dosjes së Tenderit.

Rrjedhimisht, nuk ka pasur asnjë zgjatje reale.

AK ka deklaruar se afati është shtyrë, por ka mbajtur të njëjtën datë dhe të njëjtën orë të dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

Kjo përbën kundërthënie të drejtpërdrejtë ndërmjet:

1. dispozitivit dhe arsytimit të vendimit;
2. përmbajtjes së njoftimit për shtyrjen;
3. datës faktike të hapjes së ofertave.

Pretendimi për pamundësi teknike të platformës nuk e liron AK-në nga zbatimi i vendimit

Në njoftim, AK ka deklaruar se platforma e e-Prokurimit nuk e ka reflektuar automatikisht ndryshimin e kohës së hapjes, për shkak se procedura zhvillohet në kuadër të mini-tenderit. Ky arsyetim nuk mund të përdoret për të justifikuar moszbatimin e vendimit.

Autoriteti Kontraktues është përgjegjës që procedura të zhvillohet në përputhje me vendimin e tij dhe që operatorëve ekonomikë t'u komunikohet një afat i ri, i qartë, i zbatueshëm dhe efektiv.

Nëse platforma nuk lejonte ndryshimin automatik, AK duhej të ndërmernte masat procedurale të nevojshme, përfshirë:

- koordinimin me administratorin e platformës;
- anulimin ose pezullimin teknik të afatit ekzistues;
- publikimin e një afati të ri;
- ridërgimin e ftesës për ofertim;
- ose përdorimin e një mekanizmi tjetër të lejuar për sigurimin e zgjatjes reale.

Problemet teknike ose kufizimet e platformës nuk mund t'u transferohen operatorëve ekonomikë dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për shkurtimin e kohës së përgatitjes së ofertave.

Mungesa e zgjatjes efektive ka cenuar të drejtat e operatorëve ekonomikë

Vendimi është nxjerrë më **24.07.2026**, ndërsa hapja e ofertave është mbajtur ose është paraparë të mbahet më **27.07.2026 në ora 13:30**.

Brenda kësaj periudhe përfshihet fundjava, çka e zvogëlon edhe më shumë kohën reale të punës për operatorët ekonomikë.

Operatorët duhej:

- ta analizonin vendimin;
- t'i identifikonin të gjitha ndryshimet në specifikime;
- të komunikonin me prodhuesit ose distributorët;
- të siguronin konfigurime dhe kode të reja produktesh;
- të verifikonin garancinë në sistemin e prodhuesit;
- të siguronin çmime dhe afate furnizimi;
- të përditësonin dokumentacionin teknik;
- të përgatitnin dhe dorëzonin ofertën.

Mbajtja e afatit të njëjtë e ka bërë të pamundur ose tepër të vështirë përshtatjen reale të ofertave me Dosjen e korrigjuar të Tenderit.

Korrigjimi i Dosjes pa dhënien e kohës së nevojshme për përshtatjen e ofertave e bën të drejtën për konkurrim vetëm formale.

AK ka vepruar në kundërshtim me vendimin e vet

Vendimi administrativ i nxjerrë nga AK prodhon pasoja juridike dhe duhet të zbatohet sipas përmbajtjes së tij.

AK nuk mund:

- ta aprovojë pjesërisht kërkesën;
- të vendosë korrigjimin e Dosjes;
- të vendosë zgjatjen e afatit;
- dhe më pas ta mbajë të pandryshuar afatin fillestar.

Një veprim i tillë cenon:

- sigurinë juridike;
- besimin legjitim të operatorëve ekonomikë;
- transparencën;

- trajtimin e barabartë;
- efektivitetin e mjetit juridik.

Kërkesa për rishqyrtim nuk mund të konsiderohet e trajtuar në mënyrë efektive nëse vendimi i nxjerrë për të nuk zbatohet.

KËRKESA PËR MASË TË PËRKOHSHME

Duke marrë parasysh se vazhdimi i procedurës, hapja ose vlerësimi i ofertave dhe eventualisht dhënia e kontratës mund ta bëjnë ankesën joefektive, kërkojmë që OSHP: **ta pezullojë aktivitetin e prokurimit nr. 210-26-5765-5-5-8 deri në marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me këtë ankesë.**

Pezullimi është i nevojshëm për të parandaluar:

- vazhdimin e një procedure të zhvilluar mbi bazën e specifikimeve të kontestuara;
- cenimin e mëtejshëm të konkurrencës;
- krijimin e pasojave të vështira për t'u korrigjuar;
- lidhjen e kontratës para shqyrtimit efektiv të pretendimeve.

KËRKESAT DREJTUAR OSHP-së

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

1. Ta aprovojë ankesën e ARITECH SH.P.K. si të bazuar.
2. Ta pezullojë aktivitetin e prokurimit nr. 210-26-5765-5-5-8 deri në vendosjen përfundimtare.
3. Ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 24.07.2026, në pjesët me të cilat janë refuzuar ose nuk janë shqyrtuar në mënyrë substanciale pretendimet e ankuesit.
4. Të konstatojë se AK nuk e ka shqyrtuar efektin kumulativ të specifikimeve teknike dhe përputhjen e tyre me modele konkrete.
5. Të konstatojë se përgjigjet e AK-së nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm, individual dhe të verifikueshëm për secilin pretendim.
6. Ta obligojë AK-në që t'i rishikojë dhe riformulojë specifikimet teknike për të gjitha pajisjet në bazë të performancës dhe funksionalitetit minimal.
7. Ta obligojë AK-në që të lejojë konfigurime dhe kombinime portesh të barasvlershme, kur ato ofrojnë të njëjtin ose nivel më të lartë të funksionalitetit.
8. Të konstatojë se AK nuk e ka zbatuar vendimin e vet lidhur me zgjatjen e afatit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.
9. Të konstatojë se mbajtja e datës 27.07.2026, ora 13:30, nuk përbën zgjatje të afatit, pasi ajo ishte data dhe ora fillestare.
10. Ta obligojë AK-në që të publikojë një afat të ri, real dhe efektiv për dorëzimin e ofertave, pas publikimit të Dosjes përfundimtare të korrigjuar.
11. Të urdhërojë që afati i ri të jetë i mjaftueshëm për analizimin e ndryshimeve, sigurimin e ofertave nga prodhuesit dhe përgatitjen e dokumentacionit.
12. Të anulojë çdo veprim procedural të ndërmarrë mbi bazën e afatit të pandryshuar, përfshirë hapjen e ofertave, nëse ajo është zhvilluar.
13. Ta kthejë aktivitetin e prokurimit në fazën para dorëzimit të ofertave, me specifikime të korrigjuara dhe afat të ri.
14. Të ndërmarrë çdo masë tjetër që OSHP e konsideron të nevojshme për rivendosjen e ligjshmërisë, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë.

Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar formalisht një pjesë të kërkesës për rishqyrtim, por nuk i ka trajtuar në mënyrë substanciale pretendimet kryesore lidhur me efektin kumulativ të specifikimeve teknike.

Ndryshimet e bëra nuk e eliminojnë profilin e ngushtë teknik, ndërsa një pjesë e kërkesave vazhdon të përputhet në masë të lartë me modele konkrete.

Për më tepër, AK ka vendosur shprehimisht zgjatjen e afatit, por nuk e ka zbatuar atë.

Deklarimi se afati është shtyrë, ndërkohë që mbahet data fillestare **27.07.2026, ora 13:30**, është kundërtëhënës dhe juridikisht joefektiv.

Moszbatimi i vendimit të vet nga AK cenon sigurinë juridike dhe e privon operatorin ekonomik nga një mjet juridik efektiv.

Për këto arsye, kërkojmë aprovimin e ankesës dhe kthimin e aktivitetit të prokurimit në fazën para dorëzimit të ofertave, me specifikime të rishikuara dhe me afat të ri, real dhe të mjaftueshëm.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç kufizimit të konkurrencës, specifikimet teknike në formën aktuale mund të shkaktojnë edhe dëm material për Autoritetin Kontraktues. Kufizimi i numrit të operatorëve ekonomikë që mund të paraqesin oferta zvogëlon nivelin e konkurrencës dhe mund të ndikojë në rritjen e çmimeve të ofertuara. Si rezultat, ekziston rreziku që fondet publike të mos shfrytëzohen në mënyrën më ekonomike dhe efikase, duke mos siguruar vlerën më të mirë për paratë publike. Lejimi i produkteve funksionalisht të barasvlershme do të mundësonte pjesëmarrje më të gjerë të operatorëve ekonomikë, rritje të konkurrencës dhe mundësi për përfitimin e ofertave më të favorshme ekonomikisht.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të
- d) Kërkesa për Rishqyrtim e datës 21.07.2026
- e) Vendimi i AK-se rreth kërkesës për Rishqyrtim date 24.07.2026
- f) Njoftimi i datës 27.07.2026 për hapje të ofertave për datën 27.07.2026 ora 13:30
- g) https://psref.lenovo.com/syspool/Sys/PDF/ThinkCentre/ThinkCentre_neo_50t_Gen_5/ThinkCentre_neo_50t_Gen_5_Spec.PDF
- h) https://psref.lenovo.com/syspool/Sys/PDF/ThinkVision/ThinkVision_E27_40/ThinkVision_E27_40_Spec.pdf

- i) https://psref.lenovo.com/syspool/Sys/PDF/Lenovo/Lenovo_V15_G5_IRL/Lenovo_V15_G5_IRL_Spec.PDF
- j) https://psref.lenovo.com/syspool/Sys/PDF/ThinkCentre/ThinkCentre_M70t_Gen_6/ThinkCentre_M70t_Gen_6_Spec.PDF

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*